



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të,

AC-I-14-0182

F.Q. Gjilan

Ankuesja/ Padiësja

Kundër:

E paditura

Ndërmarrja Shoqërore Gjilan, administruar, nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Agim Ramadani, 23, Prishtinë**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Hajrie Shala dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-II-13-0098 të datës 15.05.2014, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 24 tetor 2019 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e padiësit, refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet, Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-II-13-0098 të datës 15.05.2014.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datën 21 shtator 2007, paditësi ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Gjilan duke kërkuar kompensimin e të ardhurave personale dhe kontributet shëndetësorë dhe pensionale, invalide, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Ai deklaron se e paditura pa të drejtë ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës që nga data 05.04.1993 deri më 23.03.1999 me ç`rast paditësi është dëmtuar materialisht dhe kërkon nga Gjykata që padinë e tij ta aprovoi si të bazuar.

Më 13.02.2012, Gjykata Komunale në Gjilan më Aktvendimin C.nr.545/07 shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën e ka dërguara në Dhomën e Posaçme për të vendosur në kompetencë të mëtutjeshme.

Më 15.02.2013, Kolegji i Specializuar -III- i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme me Aktvendim C-III-12-1404 i ofron kompetencën Kolegjit të Specializuar -II-. Në Kolegjin -II- të Specializuar, lënda merr numrin C-II-13-0098.

Më 02/10/2019 AKP-ja parashtroi mbrojtjen e vet nëpërmjet se cilës kërkoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar. Përgjigjes i bashkëngjiti Vendimin për emërimin e anëtareve të Autoritetit të likuidimit njoftimin për DHPGJS se ndaj NSH Gjilan ka filluar procedura e likuidimit dhe se Vendimi hun ne fuqi nga data 31/12/2010 si dhe njoftimin dërguar F.Q. me te cilin ai udhëzohet për mundësin e parashtrimit të kërkesave kreditore para Autoritetit të likuidimit deri me datën 25/03/2011.

Më 15.05.2014, Kolegji i Specializuar me Aktvendim C-II-13-0098 e pezulloi procedurën për këtë çështje juridike, për arsye se Ndërmarrja Shoqërore në Gjilan, është në likuidim, pezullimi mbetet në fuqi deri sa të nxjerrët një vendim tjetër gjyqësor për shfuqizimin e pezullimit, duke u bazuar në nenin 10.1 dhe 10.2 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Më 02/06/2014, paditësja parashtroi një ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktvendimit C-II-13-0098 të datës 15 maj 2014 (tani e tutje: Aktvendimi i ankimuar). Paditësi pretendon se Aktvendimi i ankimuar duhet të prishet duke u bazuar në nenin 10 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. Si dokumente ka bashkangjitur Aktgjykimi nr.C.nr.230/07 datë 10.08.2007 si dhe padinë drejtuar Gjykatës Komunale në Gjilan me 21.09.2007.

Më 23.09.2019, kryesuesi i kolegjit me Aktvendim AC-I-14-0182 liroi nga taksa gjyqësore për procedurën ankimore, duke u bazuar në nenin 468.1 të LPK-së.

Më 02.10.2019, AKP-ja parashtroi përgjigje në Ankesën kundër Aktvendimit të ankimuar, AKP-ja pretendon se ankesa është tërësisht e pabazuar në ligj.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa e pabazuar.

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit .

AKP-ja ka informuar DHPGJS-në, se Bordi i AKP-së me Vendimin e datës 31/012/2010 kishte iniciuar procesin e likuidimit të NSH-së në Gjilan, në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, AKP-ja kërkoi nga DHPGJS-ja pezullimin e të gjitha rasteve në pritje, kundër NSH-së e cila është nën likuidim.

Neni 9.1 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parasheh që likuidimi vullnetar i një ndërmarrje çon në pritje të çfarëdo procedure gjyqësore kur procedura e likuidimit është iniciuar për të siguruar trajtimin e barabartë të kreditorëve të cilët nuk mund të lejohen të ndjekin interesin e tyre individual pa marrë parasysh kreditorët e tjerë brenda procedurës së rregullt civile.

Kreditorët duhet të parashtrojnë kërkesat e tyre sipas nenit 35 të Shtojcës së Ligjit mbi AKP-në, tek Autoriteti i Likuidimit i cili pastaj e krijon listën përfundimtare të kërkesave në pajtim me prioritetet e përcaktuara me ligj.

Padia fillestare ishte një padi kreditore kundër NSH-së nën likuidim pasi që paditësi kërkoi kompensim monetar për pagat e pa paguara e cila rezultoi me një Aktgjykim në shkallë të parë.

Për më tepër paditësi ishte njoftuar nga AKP-ja me mundësin e parashtrimit të kërkesave kreditore para Autoritetit të likuidimit.

Në DHPGJS ekziston një lëndë, ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. C-IV-14-261 në pritje për tu zgjidhur nga paditësi i njëjtë me kërkesë të njëjtë.

Andaj, Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të specializuar të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor dhe ai duhet të vërtetohet, ndërsa ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Me sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27.03.2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive në lëndët në pritje.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 24 tetor 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT:

Luteni ta dërgoni këtë Aktvendim tek:

- Paditësja /Ankuesja ,
- E paditura,
- Kryesuesit të Kolegjit të specializuar të DHPGJS-së në lëndën C-II-13-0098.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
